



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>03-03/DPK</u>	Nr Prot. Br. Prot. <u>01-1332/16</u> Prot No.
Nr. i faq. Broj stranica <u>03</u> Nr. pages	Data Datum <u>01-04-2016</u> Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	31/03/2016
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP – 03-03/1291/16
PËR/ZA/TO:	z. Fitim VOKRRI Zyra e Prokurimit – Stacioni i Autobusëve SH.A Prishtinë
CC:	z. Ylber QITAKU Drejtor - Stacioni i Autobusëve SH.A Prishtinë
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: Furnizim me Teknologji Informative dhe kamera (IT)

I nderuar z. VOKRRI,

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nën par. 1.1 dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nën par. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nën par. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin: “Furnizim me Teknologji Informative dhe kamera (IT)” me numër prokurimi: NPL.ST.AUT/16/003/121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin me titull: “Furnizim me Teknologji Informative dhe kamera (IT)” me numër prokurimi: NPL.ST.AUT/16/003/121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L -237 dhe ligjin Nr. 05/L-068

A r s y e t i m

Ju si zyre e prokurimit pranë autoriteti kontraktues Stacioni i Autobusëve Sh.A - Prishtinë keni iniciuar Procedurën e Prokurimit me titull: “Furnizim me Teknologji Informative dhe kamera (IT)” me numër prokurimi: NPL.ST.AUT/16/003/121, e cila është publikuar në faqen elektronike të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik më datë 21/03/2016. Për këtë aktivitet të prokurimit keni paraparë procedurë të hapur për furnizim.

Agjencia Kundër Korrupsion ka identifikuar këtë aktivitet të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion për këtë procedurë të prokurimit në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, Agjencia ka hasur në kritere që janë në kundërshtim me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik në Kosovës.

Në “Dosja e Tenderit” ANEKSI 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, Në tabelën e specifikimeve teknike, nga pika 1 deri në pikën 8 keni përshkruar specifikacionin teknik i cili i përshtatet prodhueseve të caktuar. Sipas kërkimeve online, kemi konstatuar se specifikacioni i është përshtatur kryesisht prodhuesit HP – Për kompjuter; BENQ dhe ACER për projektor; RICOH për aparatin fotokopjues; DELL për Laptop; si dhe DAHUA për kamerat CCTV. Autoriteti kontraktues është e ndaluar të vendosë specifikim teknik që favorizojnë ose dis favorizojnë një ose më shumë operatorë ekonomik. Specifikimet teknike duhet të përpilohen në mënyrë që të përputhen me qëllimin e prokurimit dhe të ofrojnë qasje sa më të madhe të operatorët ekonomik të interesuar.

Tutje, në “Njoftim për Kontratë”, pika III.2.4)Kapaciteti teknik dhe profesional, është kërkuar që: *“Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku 2(dy) kontrata të natyrës së njëjtë në 3 (tri) vitet e fundit”*, ndërsa në dosjen e tenderit tek ANEKSI 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, në Kërkesat Administrative, është kërkuar që: *“OE duhet të ketë së paku 3 kontrata për furnizime të ngjashme me institucione publike”*. Gjithashtu në njoftim për kontratë nuk keni prezantuar specifikimin teknik i cili do të ishte udhërrëfyes për operatorët ekonomik nëse kanë kapacitete furnizuese për furnizimet e kërkuara ose jo. Kurdo që një aktivitet i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, dosja e tenderit duhet të kompletohet para publikimit të njoftimit të kontratës dhe kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike. Në rastin e juaj, tek njoftimi për kontratë keni kërkuar dy kontrata të realizuara në tre vitet e fundit, ndërsa në dosjen e tenderit keni kërkuar tre kontrata për furnizime të ngjashme. Përpos asaj që nuk përputhet numri i kontratave të ngjashme, tek dosja e tenderit keni kërkuar që ato të jenë realizuar me institucionet publike. Ju si autoritet kontraktues edhe në këtë segment keni favorizuar operator ekonomik që kanë realizuar kontrata me sektorin publik keni dhe dis favorizuar operatorët ekonomik që kanë realizuar kontrata me sektorin privat.

Tutje, autoriteti kontraktues nuk duhet të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ për prodhuesit ose operatorët ekonomik. Me caktimin e kriterëve të lartë cekura në “Dosjen e Tenderit”, ju si autoriteti kontraktues keni favorizuar prodhues të caktuar, duke i diskriminuar të tjerët në raport me favorizuesit.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi; Nenin 27 Dosja e Tenderit si dhe Nenin 28 Specifikimet teknike të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L -237 dhe ligjin Nr. 05/L-068

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon anulimin e kësaj Procedure të Prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang dhe të mos i përsëris praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

